



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 16 prot.

Kamëz, më 19.02 .2021

V E N D I M

Nr. 13 . Datë 19 . 02 .2021

PËR

MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE NDARËS
ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL DHE FSHATRAVE BRENDA TERRITORIT TË
BASHKISË KAMËZ

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.13 Datë 15.02.2021**, në mbështetje, të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligj nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.360, datë 29.05.2019 "Për miratimin e përditësuar të kufijve administrativo-territorial të njësive të vetëqeverisjes vendore" **Këshilli Bashkiak Kamëz**:

V E N D O S I :

1. Miratimin e hartës së përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorial dhe fshatrave brenda territorit të Bashkisë Kamëz, si më poshtë vijon:
 - Njësia Administrative Paskuqan si dhe fshatrat Paskuqan 2, Paskuqan 1, Baseni i Liqenit të Paskuqanit, Kodër e Kuqe, Babrru-Qendër, Babrru Kodër, Babrru Shpat, Fushë-Kërçik, Kurora Pyjore e Paskuqanit.
 - Lagjja Bathore, si dhe fshatrat Valias, Valias i Ri, Laknas, Frutikulturë, Zall-Mner, Kamëz, Bulçesh.
2. Harta e përditësuar e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, bashkangjitur ortofoton, paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territori, Bashkia Kamëz për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kabinetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nënkryetar i Këshillit

